UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË

Nr. 386 Prot.

Tiranë, më 17.11.2026

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Nr. 2283 Prot.

Tiranë, më 17.11.2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET
UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË (UMSH)
DHE
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP)

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, institucion i arsimit të lartë, përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Adrian Civici, me adresë: Bulevardi "Gjergj Fishta", 52, Tirana 1023".

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, (AKEP), autoritet rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, përfaqësuar nga Kryetari, z. Gentian Sala, me adresë: Rruga "Reshit Çollaku", Kodi postar 1001, Tiranë.

në vijim së bashku të quajtura "Palët",

Nisur nga interesi i përbashkët për të lidhur procesin mësimor me praktikën institucionale dhe për të zgjeruar njohuritë e studentëve dhe stafit akademik në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare;

Me synim zhvillimin e leksioneve të hapura, trajnimeve, praktikave mësimore dhe veprimtarive akademike e kërkimore në fusha me interes të përbashkët;

Duke riarfimuar respektimin e pavarësisë institucionale, kompetencave ligjore dhe rregullave të brendshme të secilës Palë;

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në fuqi;

Ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit nr. 46/20215 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë", si dhe akteve nënligjore përkatëse dhe rregullave të brendshme të Palëve;

Palët, bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

1. Kjo Marrëveshje përcakton kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet UMSH dhe AKEP, përmes Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, për pasurimin e procesit mësimor, zgjerimin e njohurive praktike të studentëve dhe shkëmbimin e ekspertizës me stafin akademik.
2. Bashkëpunimi u shërben kryesisht studentëve të programit të integruar 5 vjeçar në Drejtësi dhe programeve Master i Shkencave në fushat civile dhe tregtare dhe e drejtë publike. Me dakordësimin e Palëve mund të përfshihen edhe studentë të programeve të tjera të lidhura me fushat e bashkëpunimit.
3. Veprimtaritë zhvillohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, mbi bazën e barazisë dhe respektimit të kompetencave të secilës Palë, pa cënuar pavarësinë e AKEP në ushtrimin e funksioneve rregullatore.

Neni 2
Fushat e bashkëpunimit

Bashkëpunimi përfshin, brenda fushës së përgjegjësisë së AKEP:

a. kuadrin ligjor dhe rregullator të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, si dhe çështje që lidhen me zbatimin dhe përmirësimin e tij si dhe përafrimin me legjilsacionin e acquis të BE në fushën e komunikimeve elektronike;
b. rregullimin dhe zhvillimin e tregjeve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, nxitjen e konkurrencës dhe vlerësimin e efektivitetit të masave rregullatore;
c. mbrojtjen e konsumatorëve dhe të drejtave të përdoruesve, veçanërisht në lidhje me kushtet e kontratave të pajtimit, transparencën e informacionit, cilësinë e shërbimeve dhe trajtimin e ankesave;
d. procedurat administrative dhe praktikën institucionale të AKEP, përfshirë dhënien e mendimeve mbi projektaktet e hartuara nga AKEP;
e. çështje të tjera me interes të përbashkët, që lidhen me kompetencat e AKEP dhe dakordësohen paraprakisht nga Palët.

Neni 3
Kontributi i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë

UMSH, përmes Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, angazhohet:

a. të propozojë temat dhe kalendarin e leksioneve të hapura, seminareve dhe trajnimeve, në përputhje me nevojat e programeve të studimit;
b. të ftojë përfaqësues të AKEP dhe të sigurojë mjediset, pjesëmarrjen dhe mbështetjen organizative për veprimtaritë që zhvillohen pranë Universitetit;
c. të propozojë studentët për praktika mësimore sipas kritereve transparente të dakordësuara me AKEP dhe të caktojë pedagogun përgjegjës për ndjekjen akademike të tyre;
d. të përcaktojë objektivat mësimore dhe kërkesat e vlerësimit të praktikës, të informojë studentët për detyrimet e tyre dhe të bashkëpunojë për ndjekjen e pjesëmarrjes;
e. të kontribuojë me ekspertizën akademike në studime, diskutime dhe veprimtari kërkimore të dakordësuara nga Palët.

Neni 4
Kontributi i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare

AKEP, angazhohet, sipas kapaciteteve dhe në përputhje me detyrat e tij institucionale:

a. të kontribuojë me ekspertizën e stafit në leksione të hapura, seminare dhe trajnime për studentët dhe stafin akademik;
b. të mundësojë vizita studimore dhe njohjen e studentëve me organizimin, funksionet dhe veprimtarinë e institucionit;
c. të shqyrtojë kërkesat e UMSH për praktika mësimore, të konfirmojë numrin e studentëve që mund të pranojë dhe të caktojë punonjësit përgjegjës për orientimin dhe mbikëqyrjen e tyre;
d. të vërë në dispozicion të dhëna publike për qëllime kërkimore, duke respektuar kufizimet për informacionin e mbrojtur;
e. të japë, në përfundim të praktikës, konfirmimin e pjesëmarrjes dhe vlerësimin përkatës, sipas programit të dakordësuar me UMSH.
f. Të japë mendim kur është e mundur për kurrikulat si dhe të angazhojë stafin e tij si lektorë.

Neni 5
Organizimi i praktikave mësimore

1. Praktikat zhvillohen mbi bazën e kërkesës me shkrim të UMSH dhe konfirmimit të AKEP. Përpara fillimit, Palët dakordësojnë numrin dhe kriteret e përzgjedhjes së studentëve, kohëzgjatjen, orarin, objektivat, strukturat pritëse, personat përgjegjës dhe mënyrën e vlerësimit.
2. UMSH i përcjell AKEP të dhënat e nevojshme për organizimin e praktikës dhe dokumentacionin përkatës, duke respektuar parimin e minimizimit të të dhënave personale. Njohja e praktikës për qëllime akademike kryhet nga UMSH, sipas rregullave të tij.
3. Studentët kryejnë detyra me karakter mësimor nën mbikëqyrjen e punonjësit përgjegjës. Ata nuk ushtrojnë kompetenca vendimmarrëse, inspektuese ose përfaqësuese në emër të AKEP dhe nuk zëvendësojnë punonjësit e institucionit.

4. Përpara fillimit të praktikës, studentët njihen me rregullat e brendshme, masat e sigurisë dhe detyrimet për ruajtjen e informacionit, si dhe nënshkruajnë deklaratën përkatëse të konfidencialitetit. Aksesi në dokumente, sisteme ose mjedise lejohet vetëm sipas autorizimit të AKEP dhe në masën e nevojshme për detyrat mësimore.
5. Praktika mësimore nuk krijon marrëdhënie pune dhe nuk garanton punësim në AKEP. Kjo Marrëveshje nuk parashikon detyrim për pagesë ndaj studentëve. Çdo mbështetje financiare kërkon bazë ligjore dhe dakordësim të veçantë paraprak.
6. Në rast shkeljeje të rregullave ose për arsye të përligjura që pengojnë vijimin e praktikës, AKEP mund ta ndërpresë atë për studentin përkatës, duke njoftuar me shkrim UMSH dhe studentin për arsyet. Palët bashkëpunojnë për trajtimin e pasojave akademike të ndërprerjes.

Neni 6
Kontributet e përbashkëta dhe koordinimi

1. Palët bashkëpunojnë për organizimin e veprimtarive akademike e shkencore dhe, sipas interesit, për studime e publikime të përbashkëta në fushat e nenit 2.
2. Secila Palë cakton një koordinator dhe i njofton Palës tjetër të dhënat e kontaktit. Për UMSH, koordinimi realizohet përmes Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane. Koordinatorët hartojnë propozimet, ndjekin zbatimin dhe informojnë drejtuesit për ecurinë e bashkëpunimit.
3. Për çdo veprimtari ose grup veprimtarish, Palët miratojnë paraprakisht me shkrim programin, afatet, pjesëmarrësit, përgjegjësitë dhe nevojat organizative. Koordinatorët nuk marrin angazhime financiare ose detyrime të tjera jashtë autorizimit të dhënë nga institucionet përkatëse.

Neni 7
Administrimi i informacionit dhe konfidencialiteti

1. Informacioni administrohet sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionin e mbrojtur. Për qëllime mësimore përdoren, si rregull, materiale publike.
2. Marrëveshja nuk krijon të drejtë automatike aksesi në praktika pune, të dhëna personale, sekrete tregtare ose informacion tjetër të mbrojtur. Palët, stafi dhe studentët ruajnë konfidencialitetin edhe pas përfundimit të bashkëpunimit, për aq sa informacioni mbetet i mbrojtur nga ligji.
3. Publikimet e përbashkëta dhe përdorimi i emrit ose logos së Palës tjetër kërkojnë miratim paraprak me shkrim. Përdorimi i materialeve respekton të drejtat e autorit dhe citimin e burimit.

Neni 8
Mbështetja financiare

Secila Palë përballon shpenzimet e veta të zakonshme brenda burimeve të disponueshme. Kjo Marrëveshje nuk krijon detyrime automatike financiare ndërmjet Palëve. Veprimtaritë që kërkojnë financim të posaçëm realizohen vetëm pas miratimit paraprak me shkrim të kostove, burimit të financimit dhe përgjegjësive, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 9
Dispozita të fundit

1. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët dhe lidhet për 1 (një) vit, dhe rinovohet automatikisht nëse asnjë nga palët nuk njofton të kundërtën 30 ditë para përfundimit të vlefshmërisë të saj. Ndryshimet dhe plotësimet bëhen me shkrim dhe me pëlqimin e të dyja Palëve.
2. Secila Palë mund ta zgjidhë Marrëveshjen duke njoftuar me shkrim Palën tjetër të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara. Veprimtaritë dhe praktikat e filluara, përfundojnë sipas programit të miratuar, të paktën deri në fund të semestrit përkatës, përvec kur palët bien dakord ndryshe me shkrim.
3. Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje origjinale, nga 2 (dy) për secilën Palë, dhe nënshkruhet në Tiranë, më 17.11.2026.

PËR UMSH
REKTORI

Prof. Dr. Adrian Civici

PËR AKEP
KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES

Gentian Sala